



## Raport Analitik

# Përfaqësimi Politik dhe Pjesëmarrja e Grupeve të Nënperfaqësuar në Procesin Zgjedhor

### Përmbledhja ekzekutive

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi janë dy elemente dhe parime themelore të demokracisë. Demokracia është e varur nga qytetarët e saj dhe kjo pronësi shprehet përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit kuptimplotë të të gjithë qytetarëve (përfshirë përfaqësuesit nga grupet e nënperfaqësuar, p.sh. gratë, të rinjtë, minoritetet, LGBTIQ+ dhe personat me aftësi të kufizuara) në institucionet dhe proceset demokratike. Prandaj, çdo qytetari, pavarësisht nga klasa, mosha, gjinia, orientimi seksual, aftësia, grupi, kultura dhe përkatësia etnike ose fetare, i jepen të drejta dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë aktive dhe për të kontribuar në funksionimin e këtyre institucioneve dhe proceseve.

Pavarësisht rëndësisë së tyre themelore për demokracinë, promovimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit gjithëpërfshirës politik për grupet e nënperfaqësuar mbetet një sfidë e vazhdueshme. Demokracitë nuk janë gjithmonë në gjendje të ofrojnë mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe përfaqësim politik gjithëpërfshirës. Mundësi të pabarabarta për pjesëmarrje për përfaqësuesit e grupeve të nënperfaqësuar (p.sh. gratë, të rinjtë, pakicat, LGBTIQ+, personat me aftësi të kufizuara) akoma ekzistojnë në mbarë botën. Përfaqësuesit e këtyre grupeve ende nuk janë në gjendje të marrin pjesë apo të përfaqësojnë interesat e tyre në institucionet dhe proceset demokratike. Organizatat e shoqërisë civile, kryesisht ato që mbështesin personat që u përkasin grupeve të nënperfaqësuar (d.m.th. FSHDPAK, IRCA, GADC, etj.), kanë pranuar vazhdimisht mungesën e dukshmërisë së përfaqësuesve të këtyre grupeve specifike në jetën politike dhe publike në vend. Ata kanë vënë në dukje se personat që përfaqësojnë grupet e nënperfaqësuar nuk janë në gjendje t'i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre dhe shpesh gjenden në një situatë më pak të favorshme krahasuar me qytetarët e tjerë. Pozita e përfaqësuesve nga grupet e nënperfaqësuar është veçanërisht e vështirë, pasi ata shpesh përballen me sfida të shumta.

AWEN, u ngarkua nga NDI për të kryer një analizë të përfaqësimit politik dhe pjesëmarrjes së grupeve të nënperfaqësuar në zgjedhjet vendore 2023 me fokus të veçantë në pengesat ligjore, lirinë për të kandiduar për poste politike, trajtimin e drejtë nga media, burimet zgjedhore dhe trajtimin e drejtë nga organet drejtuese të zgjedhjeve. Raporti analitik kishte për qëllim përcaktimin e fushave kyçe të deficitit në diversitetin e përfaqësimit, kuptimin e shkaqeve dhe qëndrimeve të sakta për këto fusha, si dhe kuptimin e politikave dhe procedurave ekzistuese dhe kulturës së brendshme të partive politike ndaj diversitetit dhe përfshirjes.

Analiza identifikon sfidat/boshllëqet, praktikatat e mira dhe mësimet e nxjerra në lidhje me përfaqësimin politik dhe pjesëmarrjen e grupeve të nënperfaqësuar në procesin zgjedhor. Analiza duhet të shërbejë si një platformë për diskutim në lidhje me marrjen e hapave konkretë për t'i bërë partitë më përfaqësuese, gjithëpërfshirës të votuesëve në zonat që ata përfaqësojnë, pavarësisht nga identiteti i tyre etnik, racor, gjuhësor apo fetar.

AWEN gjatë këtij raporti analitik, ka kryer bashkëpunime dhe ka angazhuar përfaqësues të grupeve të shoqërisë civile që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, pakica kombëtare, LGBTIQ+, etj, me qëllim që të sigurohet që monitorimi të jetë efikas në identifikimin e kandidatëve nga grupet e nënperfaqësuar dhe rekomandimet që rrjedhin prej tij janë më të fokusuar dhe të dobishme.



### **Gjetjet kryesore të Raportit Analitik**

- ✓ Partitë politike kanë parime dhe dispozita të rëndësishme për promovimin e barazisë gjinore, por u mungojnë strategjitë për fuqizimin e të rinjve dhe grave. Pjesëmarrja politike e grave trajtohet pak më mirë se sa e të rinjve, por në mënyrë të barabartë që të dyja mbesin pas në zbatim. Nuk ka dispozita të dedikuara në statutet e partive dhe as strategji për fuqizimin e grupeve të tjera të nënpërfaqësuar, p.sh. minoritetet, LGBTIQ+, personat me aftësi të kufizuara, etj.
- ✓ Partitë politike kanë shënuar hapa pozitivë drejt barazisë gjinore në strukturat e tyre vendimmarrëse. Megjithatë, lidhshipin e partive politike në Shqipëri vazhdon të konsiderohet monopol i politikanëve meshkuj. Disa praktika pozitive janë identifikuar në Partinë Socialiste përsa i përket përfshirjes së grave në strukturat politike, megjithatë duhen ende përpjekje të shtuara për të krijuar mekanizma që rrisin besimin, mbështetjen dhe konkurrencën transparente në mënyrë që më shumë gra të përfshihen në politikëbërje si dhe të zgjidhen në role vendimmarrëse.
- ✓ Edhe pse nuk ka barrierat ligjore për përfaqësuesit e grupeve të nënpërfaqësuar për të kandiduar për poste politike, një sërë pengesash shoqërore dhe individuale i pengojnë ata të konsiderojnë një kandidim për post. Paragjykimet ekzistuese, stereotipet dhe pabarazitë strukturore me të cilat përballen grupet e nënpërfaqësuar me prejardhje të ndryshme, statusi socio-ekonomik, orientimet seksuale dhe fetë shpesh i demotivojnë ata që të eksplorojnë mundësinë e posteve publike.
- ✓ Pjesëmarrja politike nga komunitetet Rom dhe Egjiptian mbetet shumë e ulët. Diskriminimi është ende një çështje që i ndalon ata të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën politike. Aktualisht, ka mungesë të mekanizmave efektivë për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen e barabartë të grupeve minoritare në procesin zgjedhor.
- ✓ Personat me aftësi të kufizuara nuk përfshihen në asnjë statut zgjedhor të asnjë partie politike – asnjë nga partitë politike nuk ka një perspektivë të qartë se si t'i adresojë nevojat e tyre. Barrierat kryesore që pengojnë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara përfshijnë aksesin e kufizuar të mjedisit fizik dhe informacionit, të dhënat e ndara të padisponueshme për aftësinë e kufizuar, dhe stereotipet dhe paragjykimet mbizotëruese.
- ✓ Të rinjtë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar në jetën politike. Monopolizimi i partive politike nga meshkujt dhe mendësia shoqërore janë ndër pengesat kryesore që hasin të rinjtë në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në jetën politike. Tek të rinjtë ende mungon shpresa dhe besimi për mundësinë e pjesëmarrjes kuptimplotë në proceset vendimmarrëse.
- ✓ Nuk ka anëtarë të komunitetit LGBTIQ+ që kandidojnë apo marrin pjesë hapur si pjesë e komunitetit në procesin zgjedhor në Shqipëri. Pengesat për përfshirjen e tyre burojnë nga refuzimi i shoqërisë dhe ngurrimi i partive politike për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre.
- ✓ Në tërësi, ka mungesë transparence se si partitë po ndajnë fondet që marrin nga shteti për funksionim dhe fushata të rregullta. Ka vend për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien. Nuk ka mekanizma të qëndrueshëm për financimin e përfaqësuesve nga grupet e nënpërfaqësuar, nuk ka programe të qëndrueshme trajnimi që synojnë rritjen e financimit dhe aftësive për kandidatët që u përkasin këtyre grupeve të nënpërfaqësuar. Qasja e grave në financa konsiderohet një ndër pengesat kryesore që pengojnë pjesëmarrjen e grave në politikë.
- ✓ Nuk ka pengesa ligjore për t'i ndaluar kandidatët të bëjnë ankesa për trajtimin e tyre, përfshirë ato që vijnë nga grupet e nënpërfaqësuar. Kodi Zgjedhor parashikon rregulla të detajuara dhe garanci procedurale të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore – zbatimi i tij nga organet përkatëse mbetet sfidues.



## Rekomandimet kryesore

### Partitë politike duhet të:

- ✓ Miratojnë struktura të brendshme demokratike; Ligjet mbi partitë politike duhet të marrin në konsideratë përfshirjen e dispozitave që synojnë veçanërisht rritjen e pjesëmarrjes politike të përfaqësuesve nga grupet e nënpërfaqësuar (veçanërisht për përfaqësuesit nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, LGBTQ+, personat me aftësi të kufizuara) dhe të ofrojnë mbështetje dhe burime specifike për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të barabartë në zgjedhje.
- ✓ Miratojnë politika të qarta të diversitetit që theksojnë përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar. Këto politika duhet të parashikojnë masa specifike për rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së këtyre grupeve në të gjitha nivelet e strukturës partiake. Të sigurojnë që përfaqësuesit e grupeve të nënpërfaqësuar të përfaqësohen plotësisht në lidhshmëri dhe në komitetet e politikave.
- ✓ Identifikojnë dhe adresojnë çdo pengesë sistematike ose strukturore që pengon pjesëmarrjen e grupeve të nënpërfaqësuar. Kjo mund të përfshijë punën aktive për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mikpritës për të gjithë anëtarët, duke adresuar praktikën diskriminuese brenda partisë dhe duke avokuar për ndryshime në ligjet zgjedhore.
- ✓ Shfaqin angazhim aktiv me grupet e nënpërfaqësuar përmes përpjekjeve të fokusuar për kontakt. Kjo mund të përfshijë organizimin e forumeve të komunitetit, krijimin e platformave të dialogut dhe pjesëmarrjen në ngjarje që u përgjigjen interesave dhe shqetësimeve të këtyre grupeve.
- ✓ Krijojnë procese transparente dhe gjithëpërfshirëse të përzgjedhjes së kandidatëve. Kjo mund të përfshijë zbatimin e kuotave ose vendeve të rezervuara për grupet e nënpërfaqësuar, inkurajimin e grupeve të ndryshme të kandidatëve dhe sigurimin e kriterëve të drejtë të vlerësimit dhe përzgjedhjes.
- ✓ Sigurojnë mbështetje dhe burime për individët e nënpërfaqësuar që aspirojnë të kandidojnë për programe mentorimi, sesione trajnimi dhe udhëzime për strategjitë e fushatës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet garantimit që këta individë të kenë akses në mundësi dhe burime të barabarta.
- ✓ Bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile, grupet e avokimit dhe ekspertët që punojnë për çështje që lidhen me grupet e nënpërfaqësuar. Duke krijuar partneritete, partitë mund të fitojnë njohuri të vlefshme dhe të punojnë kolektivisht drejt arritjes së një përfshirjeje më të madhe.
- ✓ Sigurojnë referim më specifik për mekanizmat specifikë të financimit për të mbështetur gratë, të rinjtë dhe grupet e tjera të nënpërfaqësuar që vijnë nga buxheti i përgjithshëm që partitë marrin nga shteti për veprimtarinë dhe fushatat e tyre vjetore.

### Institucionet publike duhet të:

- ✓ Sigurojnë që ligjet për partitë politike dhe legjisllacioni përkatës i lidhur me zgjedhjet të mos dëmtojnë në mënyrë indirekte përfaqësuesit e grupeve të nënpërfaqësuar.
- ✓ Konsiderojnë legjisllacionin që kërkon që partitë politike të miratojnë procedurë demokratike për veprimtarinë e tyre të brendshme.
- ✓ Konsiderojnë masat e veçanta të përkohshme që u kërkojnë partive politike të përfshijnë një pjesë të konsiderueshme të përfaqësuesve të grupeve të nënpërfaqësuar lart në listat e tyre të kandidatëve.
- ✓ KQZ-ja dhe palët e tjera të interesuara duhet të vazhdojnë programet e edukimit të votuesve të përshtatura për nevojat e pakicave kombëtare. Ata duhet t'i japin përparësi aksesit në kanalet e informacionit dhe komunikimit për të siguruar që grupet e nënpërfaqësuar të kenë akses të barabartë në proceset përkatëse të vendimmarrjes. Kjo mund të përfshijë ofrimin e informacionit në gjuhë të shumta, formate të aksesueshme dhe përdorimin e kanaleve të ndryshme të komunikimit.
- ✓ Institucionet publike duhet të përqipen për përfaqësim të larmishëm brenda strukturave të tyre, duke përfshirë pozitave drejtuese, bordet këshilluese dhe komitetet. Kjo mund të arrihet përmes kuotave të diversitetit, praktikave gjithëpërfshirëse të rekrutimit dhe përpjekjeve të synuara për kontakt.
- ✓ Institucionet publike duhet të demonstrojnë përkushtimin e tyre për përfshirje duke udhëhequr dhe dhënë shembull. Kjo mund të përfshijë shfaqjen e rasteve të suksesshme, nxjerrjen në pah të zërave të ndryshëm në komunikimet publike, njohjen dhe nxjerrjen në pah të arritjeve të grupeve të nënpërfaqësuar në proceset vendimmarrëse.



*Aktorët ndërkombëtarë duhet të:*

- ✓ Promovojnë standardet dhe kornizat ndërkombëtare që theksojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e grupeve të nënpërfaqësuar në proceset vendimmarrëse, lehtësojnë platformat e shkëmbimit të njohurive për të ndarë praktikat e suksesshme në promovimin e përfshirjes.
- ✓ Sigurojnë mbështetje financiare dhe teknike për organizatat dhe iniciativat që fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve të grupeve të nënpërfaqësuar, duke përfshirë programet e trajnimit, seminarët dhe mundësitë e mentorimit për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre në përfshirjen në proceset vendimmarrëse. Informojnë dhe edukojnë përmes trajnimit të partive politike, gazetarëve, forcave të sigurisë dhe të tjerëve për rëndësinë e pjesëmarrjes politike të përfaqësuesve nga grupet e nënpërfaqësuar.
- ✓ Mbështesin përpjekjet për të adresuar barrierat strukturore që pengojnë përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar, si, ligjet diskriminuese, mekanizmat e brendshëm të partisë, normat dhe praktikat sociale. Kjo mund të përfshijë advokimin për reforma ligjore, promovimin e fushatave të ndërgjegjësimit social dhe mbështetjen e nismave që sfidojnë paragjykimet sistemike.

*Aktorët e shoqërisë civile duhet të:*

- ✓ Angazhohen në përpjekjet e advokimit për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e grave, të rinjve dhe grupeve të nënpërfaqësuar në politikë duke organizuar fushata, seminare dhe ngjarje publike për të nxjerrë në pah barrierat dhe sfidat me të cilat përballen dhe për të promovuar pjesëmarrjen e tyre aktive.
- ✓ Inkurajojnë dhe fuqizojnë përfaqësuesit e grupeve të nënpërfaqësuar për të kandiduar për poste dhe sigurojnë mbështetjen e nevojshme për t'i përgatitur ata si kandidatë dhe më vonë si të zgjedhur ose zyrtarë publikë.
- ✓ Llobojnë për ndryshime legjislative për të përparuar fuqizimin e përfaqësuesve nga grupet e nënpërfaqësuar.
- ✓ Mbështesin përpjekjet e advokimit të grupeve të nënpërfaqësuar për të siguruar që platformat e politikave të partive politike të adresojnë shqetësimet dhe perspektivat e tyre.
- ✓ Identifikojnë përfaqësuesit nga grupet e nënpërfaqësuar të gatshëm për të kandiduar për poste dhe të ofrojnë programe të rritjes së kapaciteteve dhe trajnimeve dhe llojeve të tjera të mbështetjes për ta.
- ✓ Krijojnë partneritete të forta ndërmjet grave në organizatat qytetare dhe grave në partitë politike dhe zyrat e zgjedhura për të ndihmuar në përparimin e një agjende të përbashkët të grave në mënyrë të koordinuar. Për më tepër, partneritetet ndërmjet organizatave qytetare - që janë kritike për arritjen dhe edukimin e qytetarëve - partitë politike dhe zyrtarët e zgjedhur të ndihmojnë në ndërtimin e rrjeteve, zhvillimin e marrëdhënieve dhe ruajtjen e besimit dhe komunikimit në nivelin bazë.

*Media duhet të:*

- ✓ Sigurojë mbulimin me ndjeshmëri gjinore të zgjedhjeve, duke shmangur stereotipet negative dhe duke paraqitur imazhe pozitive të grave si lidere.
- ✓ Paraqesë një përshkrim më të saktë dhe të detajuar të individëve me prejardhje të ndryshme dhe të kontribuojë në mënyrë aktive në shëmbjen e stereotipeve duke portretizuar grupet e nënpërfaqësuar në politikë në një mënyrë shumëdimensionale dhe pozitive. Theximi i historive të suksesit të grave, të rinjve ose individëve nga grupe të nënpërfaqësuar që kanë shkëlqyer në politikë ose në role vendimmarrëse mund të frymëzojë të tjerët dhe të sfidojë stereotipet se grupe të caktuara nuk janë të përshtatshme për poste drejtuese.
- ✓ Promovojë programet e edukimit të votuesve si dhe edukimit qytetar që synojnë veçanërisht përfaqësuesit e grupeve të synuara.
- ✓ Të shërbejë si një platformë për dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës, duke lehtësuar diskutimet mbi tema që lidhen me diversitetin, përfshirjen dhe përfaqësimin e drejtë në politikë. Duke ofruar hapësirë për këndvështrime të ndryshme, media mund të inkurajojë biseda konstruktive që nxisin mirëkuptimin dhe afrimin e komuniteteve të ndryshme.